

## KONTRATË SHITBLERJE TË KUOTËS SË KAPITALIT

Sot më datë 30.05.2024, u lidh kjo kontratë midis palëve si më poshtë:

**Në cilësinë e shitësit: Znj.Xhoana MERKAJ**, atësia: Fatmir, e datëlindjes 15.12.1995, mbajtëse e dokumentit të identitetit me numër 032575753 dhe Numër Personal: J56215053F, lindur në Poliçan, Skrapar dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“Zef Jubani”, Ndërtesa Nr.8, H.5, Apartamenti 28, Kodi postar 1019; madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Në cilësinë e blerësit: Z.Kadri BELJUL**, atësia: Enver, i datëlindjes 24.11.1995, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbajtës i dokumentit të identitetit Pasaportë me numër M0731774 dhe Numër Personal 2411995450191, lindur në Gjermani dhe banues në Shkup (RMV), Rr.“Celopek”, Nr.78, Çair, Kodi postar 1000.

### Neni 1 KUSHTET PARAPRAKE

Kjo kontratë është bazuar në Vendimin e Asamblesë së Ortakëve datë 30.05.2024.

Shitësi: Znj.Xhoana MERKAJ, është ortakë dhe zotëruese e 20% të kapitalit të shoqërisë “KAANA Build” SH.P.K., e cila është 1(një) kuote e kapitalit me vlerë 104 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë. Shoqëria: “KAANA Build”, me NUIS: M41414035A është themeluar më datë 09.02.2024 dhe regjistruar pranë QKB-së më datë 14.02.2024.

### Neni 2 SHITJA E KUOTËS SË KAPITALIT

2.1 Znj.Xhoana MERKAJ, në cilësinë e shitësit, nëpërmjet kësaj kontrate, i shet dhe i transferon blerësit Z.Kadri BELJUL dhe ky i fundit pranon dhe blen kuotën me vlerën 104 000 (njëqindkatër mijë) lekë, kjo në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë. Kjo vlerë është paguar nga ana e blerësit dhe shitësi nuk ka pretendim për të.

2.2 Titulli i pronësisë mbi kuotën do të transferohet prej shitësit të blerësit menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate.

### Neni 3 DEKLARIME DHE GARANCI TË SHITËSIT

3.1 Shitësi deklaron se është i vetmi pronar dhe titullar i kuotës dhe i të drejtave që rrjedhin prej saj dhe garanton se kuotat janë tërësisht të lira nga cdo peng, privilegj, barrë siguroese, detyrim, garanci apo cdo e drejtë tjetër me favor të të tretëve.

**Neni 4**  
**TË TJERA**

4.1 Shitësi deklaron se pavarësisht cmimit të shitjes së kuotes në marrëveshje mes paleve, pas kësaj nuk ka asnjë përgjegjësi apo detyrim për kreditë, borxhet, dividendët, detyrime të ortakut dhe situatën financiare të shoqërisë dhe nuk gëzon asnjë të drejtë lidhur me kuotën që transferohet me shitje, në cilësinë e ortakut.

4.3 Blerësi përfitues i kuotës pavarësisht cmimit të blerjes në marrëveshje mes palëve, bazuar në ligje, përgjigjet pas kësaj personalisht për çdo veprim lidhur me kuotën me fjalë dhe vlerën totale të kapitalin nominal të shoqërisë.

**Neni 5**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj kontrate dhe vetëm kur një zgjidhje e tillë nuk është e mundur mosmarrëveshja do të kalojë për zgjidhje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë, u hartua në gjuhën shqipe, në 3(tre) kopje dhe u nënshkrua nga të dyja palët si më poshtë:

**SHITËSI:**

**Xhoana MERKAJ**

Xhoana Merkaaj



**BLERËSI:**

**Kadri BELJUL**

KADRI BELJUL

